



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 40 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, si dhe nenit 19 par. 19.4 pika d) dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë, 18.12.2025, miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT ORIENTUES TË PUNËS SË KUVENDIT TË
KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2026

Neni 1

MIRATOHET Plani orientues i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Neni 2

Kuvendi i Komunës së Lipjanit planifikon ti mbajë 12 mbledhje të rregullta dhe secilës mbledhje të rregullt i paraprin mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të mbahen sipas periodës kohore me rendin e ditës sipas tabelës në vijim:

JANAR 2026	Informatë e Kryetarit mbi Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2026
	Raporti i Kryetarit mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës për periudhën Korrik – Dhjetor 2025
	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB)
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
SHKURT 2026	Bartja (rialokimi) i buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak
	Informatë mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor
MARS 2026	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2025
PRILL 2026	Shqyrtimi i informatës tremujore financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2026
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
Maj 2026	Informatë mbi Qarkoren e parë buxhetore të MF-se
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi punën e komiteteve funksionale
QERSHOR 2026	Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027-2029
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2026
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSBB-së
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi realizimin e Planit të Prokurimit
KORRIK 2026	Shqyrtimi i informatës financiare të Komunës për periudhën Mars – Qershor 2026
	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2025
	Informatë mbi Raportin e Performancës
	Informatë mbi përfundimin e vitit shkollor
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
GUSHT 2026	Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrje-shirjeve
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi Qarkoren e dytë buxhetore të MF-se

SH TATOR 2026	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2027
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027
	Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa komunale
TETOR 2026	Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës për periudhën Korrik – Shtator 2026
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
NËNTOR 2026	Informatë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale për ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore
	Shqyrtimi i propozim- vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë e Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural mbi të mbjellurat
DHJETOR 2026	Informatë mbi Planin Vjetor të Prokurimit Publik 2027
	Shqyrtimi i propozim-vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal
	Informatë mbi Planin Vjetor të Auditorit të Brendshëm 2027
	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së
	Informatë nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport
	Informatë mbi funksionimin e këshillave lokale

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave tjera ligjore, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit mban së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.2 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe më shumë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik.

4.3 Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme, urgjente dhe solemne në rastet e caktuara me dispozitat e cekura ligjore.

Neni 5

Plani i mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në nenin 3 të këtij Vendimi është orientues dhe do të mund të ketë ndryshime gjatë vitit.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

15Nr. 020/01-68728

Lipjan, më 18.12.2025

KRYESUESI I KUVENDIT

Daut Azemi

